



Prishtinë: 09.02.2017

Kodi i ZRRE-së: V_886_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1555_01_17**;

në seancën e mbajtur më datë 09.02.2017, nxori këtë:

V E N D I M

- I **APROVOHET** ankesa e konsumatorit **M. B. S. L.**, nga Besiana, si në arsyet e paraqitura në këtë rekomandim.
- II **OBLIGOHET, KESCO** që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90091132 nga korrigjimi nr.70543DPR-90091132 i datës 18.12.20014 në vlerë **28,150.49€**

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 02.08.2016 përfaqësuesi i autorizuar Sh. M. i Sh. K. të K. (B. S. L.) ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me faturimin jo real të energjisë elektrike në vlerë prej 28,150.49€ nga ana e KESCO-s. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se të gjitha shpenzimet e energjisë elektrike janë paguar nga institucioni i tij dhe se kjo ngarkesë shtesë e faturuar nuk është reale sepse sipas tyre u janë faturuar edhe humbjet në rrjet për shkak se nuk është marrë gjendja reale.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 22.11.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë vendosur për matje grupin matës nr. 97830487, me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000,396 kWh dhe TU=00000,000 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=00000,457 kVAR dhe TU=00000,000 kVAR. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbalin mbi montimin e grupit matës konstatohet se konsumatori ka TMRR=1000/5A dhe TMT=10/0.1 kV, si dhe konstante llogaritëse të shpenzimeve C=20000.

Provë: Procesverbali i montimin dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 021718 i datës 22.11.2013

Me datë 18.11.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në grupin matës nr. 97830487, ku gjendja e



shpenzimit është TL=7.601 kWh dhe TU=4.768 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=15.252 kVAR dhe TU=9.015 kVAR. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbalin mbi montimin e grupit matës konstatohet se konsumatorit i është bërë ndërrimi i TMRR, nga 1000/5A në 75/5A, si dhe konstante llogaritëse të shpenzimeve nga C=20000 në C=1500.

Provë: Procesverbali i montimin dhe demontimit të grupit matës nr. 001672 i datës 18.11.2014

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 02.12.2014 për shkak të dyshimeve në matje kanë inspektuar pikën matës të konsumatorit, ku kanë evidentuar se konsumatori ka të vendosur njehsorin kontrollues me nr.35704746 me gjendje të shpenzimeve: TL=01200,551 kWh dhe TU=00723,938 kWh, R1=00078,001 dhe R2=00013,670, TMRR me herës të transformimit 1500/5A, konstanta C=300.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr. 1242254 të datës 02.12.2014

Departamenti i Faturimit në KEDS me datë 18.12.2014 përmes urdhër lejimit nr. 705543DPR-90091132 kanë ngarkuar konsumatorin me ngarkesë shtesë prej **28,150.49€** bazuar në procesverbalin e inspektimit të KEDS-it nr.1242254 të datës 02.12.2014 duke bërë korrigjimin e faturave nga periudha 11/2013 deri në periudhën 11/2014 bazuar në shpenzimet e regjistruara në njehsorin kontrollues.

Provë: Korrigjimi nr. 705543DPR-90091132 i datës 18.12.2014

Me datë 28.06.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke kundërshtuar ngarkesën shtesë të KESCO-s bërë me datë 18.12.2014 në vlerë prej 28,150.49€, si dhe ka kërkuar që të bëhet anulimi i këtij korrigjimi.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO i datës 28.06.2016

Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 16.07.2016 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar bazuar në procesverbalin nr.1242254 të datës 02.12.2014, si dhe shpenzimet e regjistruara në njehsorin kontrollues nr. 35704746.

Provë: Përgjigja e Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 16.07.2016

Me datë 03.08.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar ngarkesën shtesë të ngarkuar nga KEDS me datë 18.12.2014, pasi që ky korrigjim nuk ndërlidhet me shpenzimet reale të krijuara.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE e datës 03.08.2016

Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë procesverbalit të inspektimit të KEDS-it nr.021718 të datës 22.11.2013 ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit të grupit matëse kanë vendosur për matje Grupin Matës (GM) nr.97830487, me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000,396 kWh dhe TU=00000,000 kWh dhe me gjendja të njehsorit reaktiv TL=00000,457 kVAR dhe TU=00000,000 kVAR. Gjithashtu në procesverbalin e KEDS-it janë evidentuar edhe të pajisjeve tjera të kësaj pike matëse si Transformatori Matës Rymor (TMRR) =1000/5A, si dhe Transformator Matës të Tensionit (TMT)=0.1kV, si dhe konstante llogaritëse të shpenzimeve C=20000. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it përveç vendosjes për matje të GM po ashtu kanë bërë edhe shqyrtimin e njehsorit me pajisje ZERA, dhe se nuk kanë evidentuar ndonjë gabim në matje të njehsorit elektrik.

Provë: Procesverbali i montimin dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.021718 i datës 22.11.2013

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit të pikës matëse me datë 18.11.2014 kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në grupin matës nr.97830487, ku gjendja në njehsorin e energjisë elektrike aktive në momentin e inspektimit ka qenë: TL=7.601 kWh dhe TU=4.768 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv ka qenë TL=15.252 kVAR dhe TU=9.015 kVAR. Në procesverbalin e KEDS-it punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se konsumatorit i është bërë ndërrimi i TMRR, nga 1000/5A në 75/5A, si dhe konstante llogaritëse të shpenzimeve nga



C=20000 në C=1500. Gjithashtu punëtorët e autorizuar të KEDS-it në procesverbal kanë evidentuar se konsumatori deri me këtë periudhë duhet të faturohet me konstantën llogaritëse C=20000, kurse nga kjo periudhe me konstantën llogaritëse C=1500 duke mos dhënë asnjë arsytim mbi ndërrimin e TMRR-ve e që si rezultat ka edhe ndërrimin e konstantës llogaritëse.

Provë: Procesverbali i montimin dhe demontimit të grupit matës nr.001672 i datës 18.11.2014.

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 02.12.2014 për shkak të dyshimeve në matje kanë inspektuar objektin e konsumatorit ku kanë evidentuar se konsumatori ka të vendosur njehsorin kontrollues me nr.35704746 me gjendje të shpenzimeve: TL=01200,551 dhe TU=00723,938, R1=00078,001 dhe R2=00013,670, TMRR me herës të transformimit 1500/5A, prej nga konstanta llogaritëse është C=300. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it gjatë inspektimit kanë evidentuar se kyçja e njehsorit, rrymat, tensionet të gjitha janë në rregull, por që njehsori dhe TMRR nuk janë të vulosura. Po ashtu punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë kërkuar që të bëhet korrigjimi i nevojshëm duke bërë krahasimet e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin nr.35704746 (sipas KEDS-it njehsor kontrollues) me njehsorin elektrik nr.97830487 ku edhe faturohet konsumatori.

Provë: Procesverbali i inspektimit i KEDS-it nr. 1242254 i datës 02.12.2014

Bordi i ZRRE-së ka analizuar korrigjimin shtesë nr.70543DPR-90091132 të datës 18.12.2014 të bërë nga Departamenti i faturimit në KEDS përmes urdhër lejimit/korrigjimit në vlerë **28,150.49€** për periudhën 12/2013 deri në periudhën 11/2014 dhe konstaton se kjo ngarkesë shtesë është bërë bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 1242254 të datës 02.12.2014, ashtu që është rritur faturimi për faktorin e korrigjimit prej 2.17 si rrjedhojë e mos përputhjes së shpenzimit të energjisë elektrike (kWh) të regjistruar në njehsorin kontrollues nr. 35704746, si dhe njehsorit nr. 97830487 ku edhe bëhet matja dhe faturimi i energjisë së shpenzuar. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE ka analizuar edhe të dhënat e përpunuara nga KEDS përfshirë edhe leximet e nxjerra nga dy njehsorët elektrike dhe krahasimi i tyre, por konstaton se korrigjimi i KEDS-it nuk mund të jep gjendjen reale të konsumatorit duke pasur parasysh se edhe përkundër korrigjimit të kWh me faktorin e korrigjimit, shpenzimet e korrigjuara si dhe ato të tanishmet në dy njehsorët nuk mund të jenë identike në asnjë rast për shkak të karakteristikave të ndryshme të pikave matëse, si dhe për shkak të mos sinkronizimit të saktë të pajisjeve matëse.

Provë: Korrigjimi nr. 70543DPR-90091132 datë 18.12.2014

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së shkresave të lëndës ka analizuar edhe Pëlqimin elektroenergjetik (PEE) nr. 7176 datë 31.10.2013 të lëshuar nga KEDS për M. e A. P., me adresë: Prishtinë, objekti-veprimtaria: B. S. L. G., si dhe edhe kushtet teknike të dhëna në PEE: a) Kushtet energjetike: 1. Fuqia e instaluar e objektit Si=1000kVA, si dhe fuqia maksimale e njëkohshme P_{mnj}=551.2 kW; dhe b) Kushtet teknike. Sipas të dhënave në Pëlqimin Elektroenergjetik është theksuar se:

1. Furnizimi i objektit me energji elektrike do të bëhet nga trafostacioni vetanak të cilin investitori do ta ndërtoj në afërsi të objektit. TS 10(20)/04 kV me S_n=1000kVA, dhe duhet të te jetë e tipit "murosur" apo "Blindë". Blloku i TM do të ketë 2+1 kthina 24 kV, 630 A, Blloku i TU të ketë dalje të mjaftueshme sipas projektit. Lidhje e objektit në tension primar do te jetë konform "Zgjidhjes Teknike" nr. 9186 të 27.12.2012. Vendi i kyçjes kthina 10 kV e TS 35/10 kV "Batllavë".
2. Matja e energjisë elektrike do të jetë gjysemindirekte në TS. Për këtë qëllim duhet të instalohet njehsori multifunksional (aktive, reaktive, maksigraf) të lidhur përmes TMRR 1500/5. Njehsori duhet te jetë i licencuar nga MTI e Republikës së Kosovës dhe i vendosur në vend të përshtatshëm ku do te ketë qasje për lexim në çdo kohë.

Bordi i ZRRE nga analiza e Pëlqimit Elektroenergjetik konstaton se furnizimi i objektit të shërbimit korrektues të Kosovës me shifër DPR – 90091132 duhet të bëhet përmes trafos TS 10(20)/04 kV icili gjendet në afërsi të objektit, dhe matja e energjisë elektrike duhet të bëhet në këtë trafo dhe atë me



TMRR 1500/5 apo me konstantë llogaritës $C=300$. Ndërsa sipas procesverbaleve të KEDS-it vërehet se matja e energjisë elektrike bëhet në kthinën 10 kV të TS 35/10 kV Batllavë me TMRR 1000/5/0 dhe TMT 10/0.1 kV, e me konstantë llogaritëse $C=20000$. Nga kjo Bordi ka konstatuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it matjen e energjisë elektrike nuk e kanë bërë sipas Pëlqimit Elektroenergjetik, e që është dashur të veprojnë sipas pëlqimit deri sa nuk ka asnjë dokument tjetër.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe sqarimet e takimit të mbajtur mes ZRRE-së dhe KEDS-it lidhur me ankesën e konsumatorit ku nga ZRRE për KEDS-in janë kërkuar sqarime shtesë dhe dokumente konkretet si, Pëlqimin Elektroenergjetik të reviduar, marrëveshjen për kyçje, si dhe marrëveshjen për bartjen e aseteve të ndërtuara nga konsumatori në KEDS. Nga sqarimet është vërejtur se KEDS-i nuk ka arritur të siguroj asnjë nga dokumentet e kërkuara nga ZRRE për të argumentuar ngarkesën shtesë, në arsyetimin se nuk ka Pëlqim elektroenergjetik të reviduar për tu bërë matje e shpenzimit të energjisë sipas PPE së reviduar.

Provë: Shkresa e ZRRE-së dërguar në KEDS

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe kërkesat e KEDS-it të datës 11.11.2013 për kyçje të LP 10(20)kV dhe TS 10(20)/0.4kV të dërguar Menaxherit të Departamentit për Zhvillim - Dizajn dhe Inxhiniering në KEDS, në të cilën theksohet se kërkesat për kyçje, janë bazuar në procesverbalet e pranimeve interne nr.7938 të datës 13.11.2013 dhe nr.7664 të datës 07.11.2013 të dy kyçjet janë evidentuar se duhet të bëhen sipas PEE-së 7176 të datës 31.10.2013. ZRRE ka analizuar raportin teknik mbi pranimin intern të kyçjes dhe konstaton se në procesverbalin nr.7938 të datës 13.11.2013 është evidentuar se konsumatori ka plotësuar të gjitha kushtet teknike të kërkuara me PEE-7176, kurse në procesverbalin nr. 7664 të datës 07.11.2013 konstatohet se janë plotësuar të gjitha kushtet për energjizimin e LP 10(20) kV nga TS 35/10 kV Batllavë deri në shtyllën e fundit të LP 10(20) kV, por duke mos e përfshirë edhe TS 10/(20)/0.4 kV pasi që nuk ka asnjë dokumentacion për TS 10(20)/0.4 kV. ZRRE pas analizimit të procesverbalit të montimit dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.021718 të datës 22.11.2013, procesverbalit të montimit dhe demontimit të grupit matës nr. 001672 të datës 18.11.2014, procesverbalit të inspektimit nr. 1242254 të datës 02.12.2014, si dhe proceseve të pranimit teknik nr. 7664 datë 07.11.2013 dhe nr. 7938 0074 datë 13.11.2013, konstaton se kyçja e konsumatorit dhe faturimi i shpenzimeve të energjisë elektrike nuk është bërë në përputhje me PEE-në nr. 7176 të datës 31.10.2013, andaj si rrjedhojë e mos respektimit të PEE-së edhe përkundër që konsumatori ka plotësuar të gjitha obligimet e parapara teknike dhe ligjore faturimi është bërë në kundërshtim me kodet dhe rregullat në fuqi.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se konsumatori me shifër DPR – 90091132 që nga fillimi është duke u lexuar dhe faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike në TS 35/10 kV kthina 10 kV dhe me njehsor elektrik nr.97830487 e me konstantë llogaritëse $C=20000$, e jo sipas PEE në të cilën theksohet se matja do të bëhet TS 10(20)/0.4 kV me TMRR 1500/5 apo konstantë llogaritëse $C=300$. ZRRE konstaton se kjo duhet të përmirësohet dhe se faturimi i konsumatorit duhet të bëhet në përputhje të plotë sipas PEE nr.7176 përkatësisht, faturimi i konsumatorit duhet të bëhet në TS 10(20)/04 përmes njehsorit nr. 35704746.

Provë: Pëlqim Elektroenergjetik nr.7176 i datës 31.10.2013, kërkesat për kyçjet e LP 10(20)kV të datës 11.11.2013 si dhe TS 10(20)/0.4 kV datë 13.11.2013 nga Divizioni i Shpërndarjes Prishtinë, si dhe procesverbalet e pranimit teknik nr. 7664 të datës 07.11.2013 dhe nr. 7938 të datës 13.11.2013

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2016 ka konstatuar se duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, procesverbalin e montimit dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr.021718 i datës 22.11.2013, procesverbalin e montimit dhe demontimit të grupit matës nr. 001672 të datës 18.11.2014, procesverbalit të inspektimit nr. 1242254 të datës 02.12.2014, proceseve të pranimit teknik nr. 7664 të datës 07.11.2013 dhe nr.7938



të datës 13.11.2013, Pëlqimi Elektroenergjetik nr.7176 i datës 31.10.2013si dhe korrigjimit nr.70543DPR-90091132 të datës 18.12.20014, ka vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: M. B. S. L., (parashtruesi Sh. M.),
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.